



BIBLIOTEKA INTEGRUESE PËR FËMIJË DHE TË RINJ

ÇKA ËSHTË BIBLIOTEKA INTEGRUESE PËR FËMIJË DHE TË RINJ?

- Biblioteka Integruese ofron medime të ndryshme për huazim.
- Oferta për medime për fëmijë dhe të rinj në gjuhët shqipe, arabe, angleze, frënge, italiane, kroate, portugeze, serbe, spanjolle, tamile dhe turke mund të të shfrytëzohet edhe në bibliotekat e kuarteve.
- Ndhmat për mësim, kurset e gjuhës, veprat dygjuhësore dhe tekstet në një gjermanishte të thjeshtë ndihmojnë integrimin e fëmijëve me gjuhë të huaj amtare.
- Fjalorët me figura, mjetet mësimore dhe veprat me informacione mbi vendet ndihmojnë mësimin në gjuhët dhe kulturat e vendeve dhe mësimin në Iklasët internacionale.

SI MUND TË SHFRYTËZOHET BIBLIOTEKA INTEGRUESE?

- Për fëmijët që posedojnë kartën e bibliotekës (shuma e reregjistrimit 8 Fr.) huazimi është gratis. Të rinjtë nga 16 vjeq dhe të rriturit paguajnë shumën vjetore prej 40 Fr. përkatësisht 50 Fr.
- Karta e bibliotekës së Bibliotekave të Winterthurit mund të merret në katin përdhësë të Bibliotekës së Qytetit dhe në të gjitha bibliotekat e kuarteve.
- Për blerjen e kartës së bibliotekës fëmijëve dhe të rinjve ju duhet pëlqimi i prindërve apo i të autorizuarve të tyre ligjorë (nënshkrimi i prindërve).
- Mediumet e Bibliotekës Integruese gjenden në katin e 1-rë të poshtëm si dhe në të gjitha bibliotekat e kuarteve. Stacione interneti dhe infrastrukturë tjetër teknike janë në dispozicion në shumicën e vendeve.
- Personeli i Bibliotekës ju ndihmon me dëshirë në rast pyetjesh që kanë të bëjnë me shfrytëzimin.
- Dëshirat për blerjen e medimeve të reja mund të paraqiten në deskun e huazimit të bibliotekës gjegjësisht.
- Informacione të tjera mund të merren tek bibliotekisti përgjegjës Christian Brassel (mail:christian.brassel@win.ch).

KUSH MUND TA SHFRYTËZOJË BIBLIOTEKËN INTEGRUESE?

- Biblioteka Integruese – ashtu si edhe i tërë rrjeti bibliotekar – është në dispozicion të popullësisë së regjionit të Winterthurit dhe të rrethinës.
- Oferta ju dedikohet, para së gjithash, fëmijëve dhe të rinjve të cilët lexojnë tekste në gjuhë të huaja dhe prindërve të tyre.
- Mësuesit në shkolla dhe edukatorët në kopshte mund të gjejnë libra për mësimdhënie në klasët etnikisht të përziera.
- Personat e angazhuar në integrimin e fëmijëve dhe të të rinjve me gjuhë të huaj amtare mund të gjejnë poashtu materiale interesante.

ORARI I PUNËS

E hënë: ora 10.00 – 18.30

E martë, e mërkurë, e premte: ora 9.00 – 18.30

E enjte: ora 9.00 – 20.00

E shtunë: ora 10.00 – 17.00

Biblioteka integruese për fëmijë dhe të rritur udhëhiqet nga Bibliotekat e Winterthurit dhe është një projekt i përbashkët i Bibliotekave të Winterthurit dhe të Forumit Interkulturor Winterthur

Projekti përkrahet nga Konfederata Zvicerane dhe nga Kantoni i Cyrihut

ib – Prospekte në shqip, arabisht, serbokroatisht, tamilisht, turqisht, portugalisht, spanjollisht, italisht, frëngjisht dhe anglisht mund të merren në Bibliotekën Integruese dhe përmes www.winbib.ch.

Rregullore për shfrytëzimin e bibliotekave

e 1 janarit 2012

1. Qyteti i Winterthurit, në kuadër të shërbimeve kulturore, drejton një rrjet bibliotekash publike. Biblioteka e Qytetit të Winterthurit ofron mjete për arsimim të përgjithshëm, shkollim të mëtejshëm dhe arsimim profesional si edhe literaturë në gjermanisht dhe në gjuhë të tjera. Bibliotekat e kuarteve, si biblioteka të përgjithshme publike, ofrojnë literaturë për fëmijë dhe të rinj, literaturë për të rritur, libra të përgjithshme tematike dhe medime të tjera.
2. Huazimi i librave dhe i medimeve të tjera është me pagesë. Abonimi vjetor për të rriturit është 50 Fr. dhe për familje 80 Fr. Fëmijët dhe të rinjtë e moshës nën 16 vjeç abonohen pa pagesë. Nxënëset, nxënësit, zanatlinjtë dhe studentët plotësisht të regjistruar paguajnë shumën e reduktuar vjetore prej 40 Fr. Për shfrytëzim të njëhershëm të bibliotekës kërkohet shuma prej 5 Fr. për mediumin e huazuar. Shërbimet speciale, sidomos huazimet me detyrim pagese në distancë, pyetjet mbi të dhënat e ndryshme statistikore dhe reprodukimet llogariten në mënyrë të veçantë.
3. Me rastin e frekuentimit të parë të bibliotekës lëshohet, duke u dëshmuar përmes lejës personale të njoftimit, kartela e bibliotekës. Kjo kartelë e koduar është me pagesë dhe është e vlefshme për Bibliotekën e Qytetit dhe për të gjitha bibliotekat e kuarteve. Fëmijëve dhe të rinjve të moshës nën 16 vjeç ju duhet nënshkrimi i njërit prej prindërve. Kaucion nga biblioteka ju kërkohet personave pa vendbanim në regjion si dhe personave në raste të tjera të veçanta.
4. Në të gjitha bibliotekat e Winterthurit mund të huazohen njëkohësisht më së shumti 50 njësi. Drejtoria e bibliotekës në raste të caktuara ose për lloje të caktuara medimesh mund të përcaktojë afate të veçanta huazimi.
5. Afati i huazimit të librave dhe të audio dhe video-kasetave është katër javë, i bestselerëve (librave më të lexuar) dhe i gazetave dy javë si dhe i videove dhe i DVD-ve dhe i Blu-ray një javë. Dhënie e tyre personave të tretë nuk është e lejueshme. Librat e huazuar, që nuk janë porositur nga ndokush tjetër paraprakisht, mund të vazhdojnë edhe më tutje. Poashtu mund të rezervohen, duke paguar shumën prej 3 Fr., edhe medimet e ndyshme. Në Bibliotekën e Qytetit në Kirchplatz medimet mund të kthehen përmes kartelës elektronike të bibliotekës edhe jashtë orarit të punës; gjatë kësaj kohe pardhoma e dorëzimit kontrollohet përmes videokamerës. Incizimet fshihen sipas rregullit pas dy ditësh, përveç në rastet kur ekziston dyshimi i veprimeve penale. Biblioteka e Qytetit e rregullon të drejtën e kyçjes përmes kartës elektronike.
6. Pas kalimit të afatit të kthimit, bibliotekat, për çdo medium të pakthyer, caktojnë dënimin paralajmërues. Për videot, DVD-të, dhe Blu-ray dita e parë e vonesës falet. Dënimi për një ditë vonesë është 2 Fr. për çdo medium. Për çdo medium tjetër vlejné këto dënime paralajmëruese: nga dita e 10-të: 2 Fr., nga dita e 20-të: 7 Fr., nga dita e 30-të: 17 Fr. Librat dhe medimet e pakthyer edhe pas vërejtjes së tretë konsiderohen si të humbura dhe si të tilla duhet të zëvendësohen.
7. Shfrytëzueset dhe shfrytëzuesit janë përgjegjës për medimet e huazuara dhe për përdorimin e tyre si dhe për respektimin e rregullave ligjore të autorësisë. Në rast të humbjes apo të dëmtimit, përveç shpenzimeve për reparimin apo zëvendësimin e tyre, ngriten edhe shpenzimet administrative.
8. Në rast të cenimit të vazhdueshëm dhe të rëndë të rregullave dhe të rregullores mbi shfrytëzimin e bibliotekave, drejtoria e bibliotekave mund t'ia ndalojë përkohësisht apo përgjithmonë abonuesit shfrytëzimin e bibliotekave. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në Këshillin e Qytetit brenda 30 ditësh nga dita e komunikimit të vendimit. Ankesa duhet të përmbajë një propozim dhe të jetë e arsyetuar. Ankesës duhet t'i bashkangjitet edhe vendimi mbi përjashtimin nga biblioteka.

Departamenti për Kulturë dhe Shërbime

Drejtues: Ernst Wohlwend, Kryetar i Qytetit